

Nr prot-6574

Dt-02/10/2017

Lenda : Kerkohet paraprakisht miratimi per cmimin/njesi minimal fillestar te shitjes se gazit shoqerues per ankand.

Drejtuar : Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "Albpetrol" Sha
Z. Koli Bele Kryetar

Per dijeni: MEI

Te nderuar zoterinj,

Shoqeria "Albpetrol" Sha ka nisur procedurat per zhvillimin e ankandit per sasine 600 mije Nm³ per nje periudhe nje vjecare dhe per 5 vjet 3 miljone Nm³.
Me shkresen Nr 53515/1 dt 12.09.2017 , Ministria e Energjitikes dhe Industrise ka miratuar formulen per cmimin minimal/njesi fillestar sipas formules:

0.8*TTF Ku

- 0.8 eshte koeficienti qe lidh cmimin e gazit tone me bursen Hollandeze .(TTF)
- TTF Cmimi I gazit Hollandez.

Çmimi I programuar i shitjes se gazit nga Shoqeria "Albpetrol" per vitin 2017 eshte 26 leke /Nm³. Ne baze te formules se miratuar si dhe duke marre per baze çmimin e burses hollandeze , te dates 25.09.2017 ne te cilen cmim eshte 17.956 € mwh si dhe kursin e euros te publikuar nga Banka e Shqiperise te dates 25.09.2017 ku 1 € = 133.76 leke, rezulton se çmimi minimal fillestar I shitjes del 15 lek/Nm³ gaz

Ne Urdherin Nr .83 date 10.2.2012 " Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure (nafte brut), I ndryshuar me (urdherin Nr 101 date 17.04.2015 ,urdherin Nr 258 dt 03.08.2016) ne piken 6 te tij percaktohet: Ne rast se çmimi /njesi minimal fillestar I shitjes rezulton me i ulet se çmimi I shitjes I programuar nga "Albpetrol" Sha , ky çmimi miratohet paraprakisht nga ana e Keshillit mbikqyres te shoqerise dhe njoftohet MEI.

Per sa me siper , per te vazhduar proçedurat e zhvillimit te ankandit , meqenese çmimi/njesi minimal fillestar i shitjes sipas formules se miratuar rezulton me i ulet se çmimi i programuar nga Albpetrol sha per vitin 2017 , Kerkojme paraprakisht miratimin tuaj.
Bashkelidhur ju dergojme :

- Kopje e kursit te kembimit te dollarit sipas bankes se Shqiperise te dates 25.09.2017.
- Kopje e shkreses Nr 5315/1 date 12.09.2017 te Ministrise se Energjitikes dhe Industrise.
- Çmimi TTF ne bursen e Hollandes.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin, mbetemi ne pritje te miratimit nga ana Juaj.

ADMINISTRATOR

Endri PUKA

Albpetrol sh.a NUIS J82916500U Selia Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos / Zyra në Tiranë Rruga Deshmoret e 4 shkurtit
Sky Tower, Nr 7 Tiranë
T +355383662 F +35534704415 W www.albpet



C.G.C

Shtojca 3.

FORMULARI I OFERTËS

03.10.2017

Për: Albpetrol sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7

* * *

Procedura e ankandit (nëse zbatohet): *Procedure e hapur*

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit : **Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³**

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimit Publik dt.25.09.2017 Nr. 38

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Kemi shqyrtuar dokumentet e ankandit për këtë procedurë dhe pranojmë, pa rezerva e përjashtime, kërkesat, afatet kohore dhe kushtet, e shprehura në këto dokumente;
2. Ne i përmbushim të gjitha kërkesat ligjore, të përcaktuara në dokumentet e ankandit, dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta, të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë;

(në rast të procedurës së kufizuar ose me negociim, për fazën e kualifikimit)

1. Ne shprehim interes për të marrë pjesë në procedurë, në rast për zgjedhje nga autoriteti shitës;

(në rastin e ankandit të hapur/procedurës së kufizuar ose me negociim gjatë fazës së ofertimit dhe me kriterin e çmimit më të lartë)

1. Çmimi total i ofertës sonë është 337 394 Euro pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është 404 872.8 Euro me TVSH

(në rast të ankandit të hapur/procedurës së kufizuar ose me negociim gjatë fazës së ofertimit dhe me kriterin e ofertës me avantazhe më të mëdha ekonomike)

6. Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentet e ankandit;
1. Ne kemi bërë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit;

16 Dokumentet Standarde të Ankandit Publik



849



C.G.C

1. Ne autorizojmë autoritetin shitës të verifikojë informacionin/ dokumentet, që i bashkëlidhen kësaj oferte.
1. Pajtohem për te firmosur kontratën nëse shpallem fitues.

Përfaqësuesi i ofertuesit

C.G.C. shpk

Administratori Mirel meriti

Nënshkrimi

Vula



#ashtag.al

FORMULARI I CMIMEVE TE OFERTES SE ANKANDIT

K= 0.0001 Euro/mwh pa TVSH

Zero presje zero zero zero nje Euro/mwh (me fjale)

Vendosni vleren **K** te shprehur ne euro/mwh

Perfaqesuesi i ofertuesit

C.G.C shpk

Administrator



858

RAPORT PERMBLEDHES
MBI ZHVILLIMIN E PROCEDURES SE ANKANDIT ME OBJEKT :
SHITJE GAZ SHOQERUES, SASIA 3,000,000 Nm³

Drejtuar : Titullarit te Autoritetit Kontraktor
z. Endri PUKA

Me ane te ketij raporti permbledhes, ne cilesine e Kryetarit te Komisionit te Shitjes, ne emer te ketij Komisioni si dhe ne zbatim te urdherit nr.83, date 10.02.2012 "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, deshirojme t'Ju veme ne dijeni ne lidhje me zhvillimin e ankandit me objekt: Shitje Gaz Shoqerues, sasia 3,000,000 Nm³.

Mbeshtetur ne Urdherin nr.83, date 10.02.2012 "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, Titullari i Autoritetit Shites ka nxjerre Urdherin e Ankandit me nr. 6247 prot, date 21/09/2017 me te cilin eshte vendosur hapja e procedurave te ankandit me objekt te sipercituar.

Komisioni i Shitjes pasi diskutoi dhe shqyrtoi ne perputhje me natyren e objektit qe do te shitet Materialin Argumentues per percaktimin e çmimit njesi minimal fillestar te shitjes Gaz Shoqerues, sasia 3,000,000 Nm³, shkresen e Ministrise se Energjise dhe Industrise Nr. 5315/1 prot, date 12.09.2017 per miratimin e formules per percaktimin e çmimit fillestar te shitjes se naftes brut, shkresen e Ministrise se Energjise dhe Industrise Nr. 5137 prot, date 27.07.2017, per çmimit minimal fillestar te shitjes me çmimin e Burses Brent dhe ne mbeshtetje te Urdherit nr.83 date 10.02.2012 "për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", me ndryshimet perkatese, vendosi te perفشije ne dokumentat e ankandit te dhenat dhe kriteret e kualifikimit dhe te pergatis per t'u botuar ne disa nga gazetate kombetare, ne faqen e Albpetrol sha dhe Ministrise se Energjise dhe Industrise Njoftimin e Ankandit dhe DSA-te e Ankandit.

Komisioni i Shitjes i cili nenshkruan Formularin e Deklarates se nuk ndodhen ne kushtet e konfliktit te interesit, perbehet nga 5 anetare si me poshte:

- Aranit HYSENAJ	Kryetar
- Bardhyl LEKA	Anetar
- Panajot BOÇI	Anetar
- Themion MILE	Anetar
- Oltion KAÇANI	Anetar



Me shkresen ne Nr. 6247/3 prot, date 21.09.2017 derjtuar Ministrise se Energjise dhe lindustrise eshte derguar « Urdheri per fillimin e procedurave te ankandit me objekt Shitje Gaz Shoqerues », sasia 3,000,000 Nm³.

Ne zbatimi te pikes 11 te Urdherit nr.83, date 10.02.2012 "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, me shkresen nr. 6247/4 prot, date 21.09.2017 eshte derguar per publikim, per 7 dite, ne faqen e Ministris se Energjise dhe Industrise Njoftimi i Ankandit dhe Dokumentat Standarde te Ankandit Publik. Publikimi eshte kryer dhe ky fakt konfirmohet nga printimet e faqes se internetit te ministrise te cilat administrohen ne dosje.

Me shkresen nr. 6247/5, date 21.09.2017 eshte kerkuar publikimi i njoftimit te ankandit, per 7 dite, ne jo me pak se dy gazeta, me shtrirje ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Publikimi eshte kryer konkretisht ne gazetate : "Dita", "Gazeta Shqiptare", "Panorama", "Sot", "Koha Jone", "Tema", "Mapo".

Ky fakt provohet nga gazetate e administruar ne dosje, per cdo dite ne te cilen eshte kryer publikimi i njoftimit te ankandit.

Me shkresen nr. 6247/6, date 21.09.2017 i eshte kerkuar Drejtorise se Menaxhimit te Sistemeve Informatike ne Albpetrol sha qe te beje publikimin per 7 dite te Njoftimit te Ankandit dhe Dokumentave Standarde te Ankandit Publik. Publikimi eshte kryer dhe ky fakt konfirmohet nga printimet e faqes se internetit te Albpetrol sha te cilat administrohen ne dosje.

Me pas, ne sallan ku ishte i vendosur Komisioni i Shitjes u paraqit vetem nje oferte, konkretisht nga :

- « C. G. C. » Shpk

Oferta e vetme e paraqitur nga ofertuesi « C. G. C. » Shpk, ne prani te Komisionit te Shitjes u mor ne dorezim nga punonjesja e protokollit ne Albpetrol sha Znj. Stela Sila e cila e protokolloi ate me Nr. 6575 prot, date 03.10.2017, ora 10 :55. Kjo oferte, pasi protokollohet nga punonjesja e protokollit te shoqerise Albpetrol sha i dorezohet Komisionit te Shitjes per te vazhduar me proceduren e vleresimit.

Perfaqesuesi i Ofertuesit u ftua qe te nenshkruaje deklaraten per konfliktin e interesit. Meqenese operatori nuk kishte lidhje pune, gjaku apo interesi me anetaret e Komisionit te Shitjes, ai nenshkroi deklaraten perkatese e cila administrohet ne dosjen e ankandit.

Anetaret e Komisionit te Shitjes, ne prani edhe te operatorit te paraqitur numeruan fletet e ofertes se dorezuar dhe lexuan me ze te larte emrin e shoqerise qe kishte paraqitur oferte.

Ne baze te leximit dhe numerimit te kryer rezultoi si me poshte :

- Eshte paraqitur oferte nga Ofertuesi « C. G. C. » Shpk

Anetaret e Komisionit te Shitjes firmosen nga mbrapa oferten ekonomike te paraqitur nga ofertuesi.



Pasi mbyllet seanca publike, perfaqesuesit e ofertuesve marrin nje kopje te ketij procesverbalit dhe njoftohen te paraqiten ne date 09.10.2017 ne ora 11:00 ne ambientet e Ministrine e Energjise dhe Industrise per vazhdimin e procedurave te ankandit, pasi komisioni i shitjes gjykoi se i duhej me shume se nje dite pune kohe per te kryer vleresimin e ofertes.

Pas shqyrtimit te te gjithë dokumentacionit te paraqitur, pasi beri verifikimin nese kishte gabime aritmetike dhe rezultoi se nuk kishte te tilla, Komisioni i Shitjes unanimisht vendosi :

Te kualifikoje oferten e paraqitur nga shoqeria « C. G. C. » Shpk pasi eshte ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne ftesen per oferte dhe Dokumentat Standarde te Ankandit Publik.

Komisioni i Shitjes, bazuar ne Dokumentat Standarde te Ankandit Publik si edhe ne piken 14 te urdherit "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", i ndryshuar percakton se vlefte e hapit qe do te perdoret ne ankand te jete 5% e ofertes me çmimin më të lartë të kualifikuar.

Me pas, Komisioni i Shitjes therret ofertuesin per te zhvilluar proceduren e ankandit. Operatori « C. G. C. » Shpk, pasi i'u komunikua nga Komisioni i Shitjes vlefte e hapit 5% e ofertes me çmimin më të lartë të kualifikuar, paraqiti nje deklarate sipas te ciles ai deklaroi se nuk e pranon hapin dhe se oferta e paraqitur ne ankand ne momentin e dorezimit te dosjes eshte oferta e tij perfundimtare. Kjo deklarate administrohet ne dosjen e ankandit nga Komisioni i Shitjes.

Ne perfundim te procedures se shitjes, Komisioni Shitjes vendosi:

Oferta e kualifikuar e shoqerise « C. G. C. » Shpk te shpallet fituese, per arsye se shitja e gazit shoqerues nga « Albpetrol » sha u realizua me cmim/njesi me te larte te ofruar ne kete ankand.

K= 0.0001 Euro/mwh pa TVSH (zero presje zero zero zero nje euro/mwh)

Per sa me sipër bazuar ne Urdherin nr.83, date 10.02.2012 "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, pas perfundimit te afatit ligjor per paraqitjen e ankesave, me cilesine e Kryetarit te Komisionit te Shitjes, ju propozojme me ane te ketij Raporti Permbledhes te shpallni fitues te ankandit shoqerine « C. G. C. » Shpk me çmim te ofruar si me poshte :

K= 0.0001 Euro/mwh pa TVSH (zero presje zero zero zero nje euro/mwh)

Date 16.10.2017
KOMISIONI I SHITJES
KRYETARI

ARANIT HYSENAJ

MIRATOHET
TITULLARI I AUTORITETIT SHITES

z. ENDRI PUKA

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos / Tiranë, Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Pall. Sky Tower, Kati 7
T +3553813662 F +35534704415 W www.albpetrol.al

Nr. 6247 / ³ Prot.
21 / 09 / 2017

Lënda: Dërgohet Urdhëri për fillimin e procedurave të ankandit me objekt:
"Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³".

Drejtuar: Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë
Z. Damian Gjikhuri, Ministër

I nderuar Z. Ministër!


Shoqëria "Albpetrol" sha ka filluar procedurat për zhvillimin e ankandit me objekt:
"Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³".

Në bazë të urdhërit nr. 83, datë 10.2.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, po Ju dërgojmë bashkëngjitur një kopje të urdhërit për fillimin e procedurës së shitjes me ankand.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

ADMINISTRATORI

ENDRI PUKA



Lënda: Dërgohet për publikim Njoftimi i Ankandit dhe DSA e Ankandit me objekt:
Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³.

Drejtuar: Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Shoqëria "Albpetrol" sha ka filluar procedurat për zhvillimin e ankandit me objekt: Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³.

Jeni të lutur që të publikoni Njoftimin e Ankandit dhe Dokumentat Standarde të Ankandit ne faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Njoftimi dhe dokumentat e Ankandit te jenë të publikuara prej dates 25/09/2017 dhe t'i krijojnë mundësinë subjekteve te interesuara për të bërë shkarkimin e tyre nga faqja e internetit.


Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbeshtetese, ne Ministrine e Energjise dhe Industrise, eshte e lutur te marre te gjitha masat per sigurimin e ambjentit dhe kushteve te pershtatshme per zhvillimin e ankandit

Bashkëngjitur do të gjeni një CD me Njoftimin e Ankandit dhe Dokumentat Standarde të Ankandit.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

ADMINISTRATORI

ENDRI PUKA



URDHËR – ANKANDI

Mbeshtetur ne Aktin Normativ nr.2 date 18.06.2010 "Per nje shtese ne ligjin nr.7746 date 28.07.1993 Per hidrokarburet (kerkimi dhe prodhimi)", te ndryshuar, ne Urdherin nr.83, date 10.02.2012 "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", te ndryshuar, si edhe ne shkresen e Ministrit te Energjise dhe Industrise nr.5315/1 prot, date 12/09/2017,

Urdheroj

Hapjen e procedurave te ankandit per shitjen e gazit shoqerues me te dhenat e meposhteme:

1. **Objekti:** Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³
2. **Vendndodhja e gazit shoqerues:** Albpetrol sha, vendburimi Cakran Mollaj.
3. **Vlera fillestare e shitjes:**

$$C_{mimi} = 0,8 \times TTF + K$$

- TTF eshte cmimi ne euro/mwh i gazit shoqerues te publikuar ne bursen hollandeze.
- K- eshte vlera euro/mwh e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal te shitjes te perlllogaritur nga formula ($K \geq 0$).
- Per konvertimin e cmimit nga euro/mwh ne euro/Nm³ per gazin e vendburimit Cakran Mollaj do te perdoret koeficienti 0.00781.

4. Sasia totale e gazit shoqerues per ankand: 3 000 000 Nm³.
5. Afati per evadimin: 600 000 Nm³ brenda 1 viti nga data e nenshkrimit te kontrates dhe 3 000 000 Nm³ brenda 5 viteve nga data e nenshkrimit te kontrates.
6. Lloji i procedures: Procedure e hapur

Arsyeja e perdorimit te kesaj procedure eshte Akti Normativ nr.2 date 18.06.2010 "Per nje shtese ne ligjin nr.7746 date 28.07.1993 Per hidrokarburet (kerkimi dhe prodhimi)", i ndryshuar, Urdheri nr.83, date 10.02.2012 "Per rregullat dhe procedurat e shitjes se produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, i cili ne piken 1 te tij parashikon se: Shoqëria "Albpetrol" sh.a. Patos është përqejëse për shitjen me ankand me anën e procedurës së hapur të produkteve hidrokarbure për tregun vendas me qëllim përpunimin e tyre dhe/ose për eksport.

7. Komisioni i shitjes te jete me perberje si me poshte:

Aranit Hysenaj	Kryetar, N/Drejtor Teknik, Ekonomist.
Bardhyl Leka	anetar, Drejtor, Drejtoria e Prodhimit
Panajot Boci	anetar, Drejtor, Drejtoria e Finances
Themion Mile	anetar, K/Specialist Drejtoria Juridike, Jurist.
Oltion Kacani	anetar, Specialist, Drejtoria Juridike, Jurist.

8. Shitja e naftes brut do te behet konform Urdherit nr.83, date 10.02.2012 i ndryshuar, duke mare si çmim fillestar te shitjes formulen e propozuar nga grupi i eksperteve dhe te miratuar nga Ministri i Energjise dhe Industrise, si dhe duke hartuar dokumentat sipas dokumentave standarte te ankandit publik.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

ADMINISTRATORI

ENDRI PUKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

Nr. 5315/1 Prot.

Tiranë, më 12/10/2017

Lënda: Dërgohet miratimi për vazhdimin e procedurave për shitjen e gazit shoqërues sipas "Formulës së përcaktuar nga grupi i ekspertëve për çmimin minimal fillestar të shitjes së produktit hidrokarbur gaz shoqërues".

Drejtuar: Z. Endri Puka
Administrator
"Albpetrol" sh.a.
Lagjia "1 Maji"

PATOS

I nderuar zoti Puka,

Shoqëria "Albpetrol" sh.a. në zbatim të ligjit nr. 10298, datë 08.07.2010, "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993, "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", si dhe Urdhrit të Ministrit, nr. 83, datë 10.02.2012, "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", të ndryshuar, nëpërmjet shkresës së saj Nr. 5137, datë 27.07.2017, ka dërguar në MEI propozimin për miratimin e "Formulës së përcaktuar nga grupi i ekspertëve për çmimin minimal fillestar të shitjes së produktit hidrokarbur gaz shoqërues", për gazin shoqërues të prodhuar në vendburimet Cakran Mollaj dhe Ballsh Hekal.

Referuar propozimit për çmimin minimal fillestar të shitjes së produktit hidrokarbur gaz shoqërues të përcjellë me këtë shkresë të Albpetrol sh.a., shprehemi dakord që sasia prej 600 mijë Nm3 e produktit gaz shoqërues për periudhën 1 (një) vjeçare dhe për 5 (pesë) vjet 3 milionë Nm3, të shitet me çmimin minimal/njësi fillestar sipas formulës


$$\text{Çmimi} = 0,8 \times \text{TTF}.$$

Përsa më sipër vazhdoni procedurat përkatëse sipas Urdhrit të Ministrit, nr. 83, datë 10.02.2012, "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", të ndryshuar.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTRI

DAMIAN GJINJURI



has and here identified that you will need to modify your network settings to continue accessing our site in the future. Please
contact us at support@theics.com for more details.


LAST
18.100

TIME(GMT)
10/4/2017
10:18 AM

% CHANGE
0.958

VOLUME
2295

LAST UPDATE TIME: 10-04-2017 11:07 AM GMT



LAST

TIME(GMT)

% CHANGE

VOLUME

data

1/4

BANKA E SHQIPËRISË

Kursi zyrtar i këmbimit

Kursi zyrtar i këmbimit ("fiks") llogaritet sipas Udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së "fiksit" të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë" miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës, Nr.66, datë 30.08.2006. Më poshtë jepet kursi zyrtar i këmbimit të monedhave të huaja përkundrejt monedhës vendase LEK.

Kërkimi mund të bëhet duke plotësuar periudhën dhe monedhën që ju intereson.

Periudhë 25.09.2017 - 25.09.2017

Monedha EUR Mënyra e shfaqjes: Tabelë

KËRKO

Kriteri e kërkimit

Periudha kohore: 25.09.2017 - 25.09.2017

Monedha e zgjedhur: Euro (EUR)

Data

25.09.2017

Lekë për njësi të monedhës së huaj

133.76

Copyright © 2004 Banka e Shqipërisë. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

10/4/2017, 1:11